



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Informacionit të Bashkisë Shkodër

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 50312310-1 - Mirëmbajtje e pajisjeve të rrjetit të të dhënave

VLERA E FONDIT LIMIT: **1,644,167** (një milion e gjashtëqind e dyzet e katërmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:
 - a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
 - b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit e konkretisht **657,666** (Gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtë) lekë

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” “Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohe nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në

procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **657,666** (Gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatëdhjetë e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë që është 40% e vlerës së fondit limit lotit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, ”Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë

30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe konkretisht **328,833** (Treqind e njezet e tetemije e teteqind e tridhjetë e tre) lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4.. *ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësor. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën si dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar*

duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar, vlera për shërbime të ngjashme prej **328,833** (Treqind e njezet e tetemije e teteqind e tridhjetë e tre) lekë.

përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 20% të fondit limit.

2.3.2 Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik çertifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, si më poshtë, ose ekuivalente, të lëshuara nga organizma ndërkombëtare ose shoqëri të akredituara në Republikën e Shqipërisë, të cilat duhet të jenë të vlefshme datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik:

- a. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatën ISO 9001:2015 (standardi i menaxhimit të cilësive) ose ekuivalente, e cila duhet të përkojë me kategorinë dhe specifikën e produkteve dhe të shërbimeve që prokurohen.
- b. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatën ISO/IEC 27001:2013 (standardi i sigurisë së informacionit) ose ekuivalente, e cila duhet të përkojë me kategorinë dhe specifikën e produkteve dhe të shërbimeve që prokurohen.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik ofertues në këtë procedurë, secili prej operatoreve ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatën ISO të renditura në pikat a-b më lart, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë në akt marrëveshjen midis palëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë dhe mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit, planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit/shërbimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi: Kërkesat për certifikim sipas standardeve ISO bazohet në përcaktimet e pikës 4 të Nenit 77-Kërkesat për Kualifikim, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, konkretisht “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me:

- mirëmbajtjen e sistemeve informatikë brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Realizimi i sa më sipër, por jo vetëm, kërkon ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese si dhe në informacione sensitive të Bashkisë Shkodër, si rrjedhojë certifikimi ISO 27001 i operatorit ekonomik është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor për aplikimin e praktikave mbi menaxhimin e risqeve, trajtimin e të dhënave dhe shërbimeve që do të kryhen.

2.3.3. Për të garantuar cilësinë e punës operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë kapacitete dhe staf të kualifikuar.

Në lidhje me këtë kërkesë operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjese te stafit te paktën 5(pese) punonjës nga ku:

- Të paktën 2 (dy) punonjës të jenë specialistë në zhvillim dhe implementim sistemesh të diplomuar në degët e Informatikës, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, ose ekuivalente.

- Të paktën (nje) nga informaticienet e përmendur më sipër duhet të jene të certifikuar për “Smart Processes Certified Professional”, për platformën “Smart Processes” të lëshuar nga prodhuesi i tij ose ente të certifikuara/autorizuara prej tij
- Të paktën 3 (tre) punonjës të tjerë do të jenë në linjën e parë të mbështetjes teknike (First level support) duke qënë se janë 4 sisteme informatike për të cilat kërkohet marrja dhe mbledhja e kërkesave për difekte dhe me pas delegimi i tyre në stafin IT.

Per plotesimin e ketyre pikave me siper operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentat e meposhtme si:

- Diplomat e shkolles per specialistet IT/ekuivalente
- Certifikatat perkatese
- listepagesën e sigurimeve shoqerore (formularët E-sig025) per punonjësit e mesipërm për te pakten muajin e fundit

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të paraqese autorizimin e prodhuesit per shitjen e licencave te software “Smart Processes”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Në vendosjen e numrit të punonjësve është bërë një analizë bazuar te faktorët, si numri i sistmeve që do të bëhen upgrade dhe do të mirëmbahen, specifikat teknike dhe funksionale të secilit sistem, kualifikimi i punonjësve, zërat e punëve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë jep siguri dhe besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën brenda afatit dhe me cilësi.

Stafi kryesor në bashkëpunim me stafin e specializuar/të kualifikuar si dhe fuqinë tjetër punëtore do jenë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Planin e Zbatimit.

Me qëllim implementimin/konfigurimin/mirëmbajtjen objekt të kontratës në përputhje me kushtet teknike të zbatimit që do të kryhen objekt kontrate, vlerësohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e informaticienëve me kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar dhe me qëllim vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, konkretisht;

-2 (dy) punonjës me eksperiencë si specialistë në zhvillim dhe implementim sistemesh të diplomuar në degët e Informatikës, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, ose ekuivalente.

Siç është shpjeguar edhe më lart, si dhe referuar specifikimeve teknike, objekti i kësaj kontrate përfshin upgrade, instalim, konfigurim, identifikime të problemeve (bug-eve software) dhe implementimin (programimin) e zgjidhjeve si dhe ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes teknike (administrim dhe mirëmbajtje sistemi dhe baze të dhënash) në katër sisteme informatikë. Për këtë arsye është e nevojshme që të ketë personel të specializuar si programues dhe me eksperiencë në punë të ngjashme me qëllim që të garantohet që Operatori Ekonomik i ka kapacitetet dhe aftësitë për të realizuar kontratën me sukses.

-Të ketë të paktën 1 (nje) nga informaticienet e përmendur më sipër të certifikuar për “Smart Processes Certified Professional”, për platformën “Smart Processes” të lëshuar nga prodhuesi i tij ose ente të certifikuara/autorizuara prej tij.

Me qëllim realizimin e upgrade-it ,instalimit dhe konfigurimit të tre sistemeve të upgrade-uar, si dhe realizimit të shërbimeve të mirëmbajtjes teknike dhe operacionale, sipas specifikimeve teknike, të katër sistemeve, tre nga të cilët janë ndërtuar mbi platformën “Smart Processes”, vlerësohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë të paktën nje specialist të kualifikuar për të kryer punët e përcaktuara në kontratë në përputhje me specifikimet teknike. Operatori Ekonomik duhet të azhurnojë (upgrade) platformën ekzistuese dhe mbi platformën e azhurnuar të kryejë të gjitha konfigurimet për secilin proces. Në vijim, Operatori Ekonomik duhet të ofrojë shërbime mirëmbajtje ku përfshihen proceset e mirëmbajtjes rutinë (të sistemit dhe bazës së të dhënave) si dhe zgjidhje problematikash dhe ndërtim/zhvillim dhe implementim zgjidhjesh mbi platformë për rregullimin e tyre. Për këtë arsye është e nevojshme që Operatori Ekonomik të angazhojë në projekt staf që ka njohuri të thella mbi platformën “Smart Processes” si dhe kapacitetet për të kryer konfigurime dhe rregullime (programime) mbi këtë platformë, me qëllim që të mund të realizojë punët e përcaktuara në specifikimet teknike. Dëshmitë e kërkuara janë të nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor dhe për të vërtetuar se Operatorët Ekonomikë do të angazhojnë në projekt staf që i ka këto njohuri dhe kapacitete. Certifikata e kërkuar vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit dhe është në përputhje të plotë me natyrën dhe përmasat e kontratës. Nga ana tjetër, duke qenë se shërbimet e mirëmbajtjes vjetore do të ofrohen për katër sisteme të ndryshme, dy prej të cilave janë shumë kompleks, ndërsa shërbimet e upgrade-it dhe konfigurimet do të ofrohen për tre sisteme, volumi i punës që kërkohet të realizohet nga Operatori Ekonomik është i madh. Për këtë arsye, OE duhet të ofrojë mjaftueshëm staf për të menaxhuar dhe ofruar shërbime me cilësi dhe në kohë, sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, gjithashtu, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 7 personave, është në përputhje me volumnin dhe natyrën e punës.

-të paktën 3 (tre) punonjës të tjerë do të jenë në linjën e parë të mbështetjes teknike (First level support) duke qënë se janë 4 sisteme informatike për të cilat kërkohet marrja dhe mbledhja e kërkesave për difekte dhe me pas delegimi i tyre në stafin IT.

Mirëmbajtja e sistemeve përfshin përveç pjesën e mirëmbajtjes teknike dhe atë operacionale. Si e tillë kërkohet që përveç stafit teknik informaticienë të këtë staf shtesë I cili do të mbledhë të gjitha kërkesat për difekte teknike ose asistencë në forma të tjera. Duke qënë se janë 4 sisteme informatike thjeshtojmë së vetëm për SiTTV dhe SiZIN duke u bazuar në një analizë nga vitet e kaluar ka një numër kërkesash për asistencë që varion nga 30-40 kërkesa në muaj. Kjo kërkon që OE duhet të ketë personel që të jetë në linjën e parë të marrjes së kërkesës, i cili me pas e kalon atë të zyrës informatike duke mundësuar kështu një menaxhim sa më efektiv të të gjitha kërkesa që sjell si rrjedhojë një funksionim sa më të mirë të sistemeve.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit për shitjen e licencave të software “*Smart Processes*”.

Argumentimi: Sistemet që do të azhurnohen (upgrade) janë të ndërtuar mbi platformën “Smart Processes” për të cilat Bashkia Shkodër disponon licencat e përdorimit për versionin që ka (3.0) të autorizuar nga prodhuesi. Kjo garanton që bashkia zotëron dhe përdor sisteme të ligjshme dhe është në përputhje me dispozitat ligjore. Duke qënë se sistemet do të bëhen upgrade në një version të ri (më të lartë), është e domosdoshme që bashkia të pajiset me licencat për versionin e ri (4.0) në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria ligjore. Autoriteti Kontraktor duhet të vërtetojë që Operatori Ekonomik ka autorizimin e duhur nga prodhuesi për të shitur licensën e versionit të ri të platformës “Smart Processes”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si

dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në linjë të plotë me vizionin e qeverisë dhe Axhendën Dixhitale të Shqipërisë, Bashkia Shkodër ka ndërmarrë një sërë iniciativash për përmirësimin e shërbimeve dhe komunikimin me qytetarët duke ofruar shërbime të shpejta, cilësore, transparente dhe të dixhitalizuara. Për këtë qëllim Bashkia Shkodër ka të implementuar dhe përdor sisteme informatike të integruara, tre prej të cilave (Sistemi i Informacionit të Shërbimeve Sociale, Sistemi i Integruar i Zyrave me Një Ndalesë dhe Sistemi i Taksave dhe Tarifave Vendore) janë ndërtuar mbi platformën “Smart Processes”. Platforma online Transparenca e Buxhetit është ndërtuar në asp.net dhe SQL Server Express si Sistem të menaxhimit të bazës së të dhënëve. Këto sisteme i kanë mundësuar bashkisë të automatizojë proceset e saj të brendshme dhe ruajtje dhe përdor të dhëna elektronike që nga viti 2016. Që nga implementimi dhe vënia në funksionim e këtyre sistemeve, të gjitha proceset që lidhen me shërbimet sociale, menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore, ofrimin e shërbimeve administrative dhe ofrimin e transparencës mbi mbledhjen e të ardhurave dhe ekzekutimin e buxhetit, kryhen vetëm përmes tyre. Për këtë arsye, vijueshmëria e përdorimit të sistemeve dhe marrja e masave që këto sisteme të jenë eficientë, bashkëkohore dhe të sigurta është e një rëndësie të veçantë. Tre nga sistemet objekt të kësaj kontrate janë ndërtuar mbi softëare “Smart Processes”, versioni 3.0 dhe megjithëse janë ndërtuar në përputhje me kërkesat e bashkisë, gjatë viteve, herë si rrjedhojë e ndryshimeve ligjore, herë për shkak të përmirësimit/ndryshimit të proceseve të brendshme të punës dhe herë nga sugjerimet, rekomandimet apo kërkesat e stafit që punon me sistem, ka lindur nevoja që funksionalitetin e tyre të përmirësohen, ndryshohen apo përshtaten. Nga ana tjetër, zhvillimet e shpejta të teknologjisë, mundësojnë që sistemet të pajisen me funksionalitete të reja apo të optimizojnë ato ekzistuese duke ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në rritjen e cilësisë, efektivitetit dhe efikasitetit të punës. Sistemet aktualë janë ndërtuar duke përdorur teknologji që tashmë konsiderohet e vjetëruar dhe që në vitet e fundit ka limituar

pasurimin e sistemeve me funksionalitete të reja dhe optimizimin e atyre ekzistuese. Veç kësaj, teknologjitë e vjetra shfaqin gjithnjë e më shumë bug-e për shkak edhe të ndërhyrjeve të shpeshta gjatë mirëmbajtjes, të cilat me kohën shkaktojnë degradim të sistemit dhe ulje të ndjeshme të performancës, si dhe shndërrohen në sisteme të pasigurta dhe janë vulnerabël ndaj sulmeve kibernetike. Për këtë arsye është e nevojshme që sistemet të bëhen upgrade me teknologjinë e fundit . Në vijim, në përputhje dhe me VKM Nr. 710, datë 21.8.2013 (i ndryshuar), Bashkia Shkodër duhet të sigurojë shërbime mirëmbajtje për sistemet informatike që përdor. Për sa më sipër Bashkia Shkodër ka planifikuar të sigurojë shërbime mirëmbajtje për 4 (katër) sisteme informatikë dhe shërbime upgrade për tre prej tyre. Specifikimet teknike janë hartuar duke patur parasysh specifikat teknike dhe operacionale të secilit sistem si dhe nevojat që ka bashkia për sigurimin e funksionimit të qendrueshëm të këtyre sistemeve me qëllim zhvillimin me efikasitet dhe efijencë të punës së saj.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.